



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

*Dokument parlamentar*

*Tiranë, më 24.01.2022*

**RAPORT**

(Për dhënie mendimi)

**PËR**

**PROJEKTLIGJIN**

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (HUAMARRËSI), DHE AGJENCISË FRANCEZE PËR ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “POLITIKA PËR MBËSHTETJEN E REFORMËS NË SEKTORIN ENERGETIK NË SHQIPËRI”**

• **Hyrje**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 19.01.2022, mori në shqyrtim projektligjin projektligjin “Për Ratifikimin E Marrëveshjes Së Huas, Ndërmjet Republikës Së Shqipërisë, Përfaqësuar Nga Ministria E Financave Dhe Ekonomisë (Huamarrësi), Dhe Agjencisë Franceze Për Zhvillim, Për Financimin E Projektit “Politika Për Mbështetjen E Reformës Në Sektorin Energjetik Në Shqipëri”

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Z. Eduard Ndreca.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm dhe përfaqësues nga ministria përgjegjëse për Financat dhe Ekonominë, Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre, si dhe përfaqësues të tjerë të Ministrisë Znj. Kesiana Halili.

## **I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT, VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj dhe në nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji, rezulton se fusha që rregullon ky projektligj **nuk përfshihet** në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet **rregullit të përgjithshëm** për sa i përket shumicës.

## **II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ**

Nëpërmjet këtij projektligji specifikisht synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim (huadhënësi), nëpërmjet së cilës qeveria e Republikës së Francës i jep mundësi Republikës së Shqipërisë të marrë një kredi të butë, për të përmirësuar proceset e reformës sektoriale në sektorin energjetik në Shqipëri duke plotësuar angazhimin ndërkombëtar lidhur me këtë reformim, i cili do të përfshijë, ndër të tjera, konsolidimin e ndarjes së OSHEE-së – Furnizuesit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, funksionimin e Bursës së Energjisë (APEX) dhe hapjen graduale të tregut të shitjes me pakicë, së bashku me krijimin e një tregu konkurrues të energjisë sipas Vendimit Nr. 480 të Këshillit të Ministrave, datë 31.7.2018 “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË ENERJISË PËR PERIUDHËN 2018–2030”.

Strategjia Kombëtare e Energjisë – Shqipëria 2030, është një moment shumë i veçantë për sektorin energjetik në Shqipëri. Pas një pune intensive, kemi të përfunduar dokumentin më të rëndësishëm për sektorin e energjisë, një udhërrëfyes ky i cili vendos piketat kryesore për modelet e zhvillimit të një prej promotorëve kryesorë të ekonomisë. Miratuar aktet ligjore dhe nënligjore në përputhje me direktivat evropiane. Bazuar në mbështetjen e gjithanshme të Sekretariatit të Energjisë është bërë i mundur miratimi i ligjit të energjisë elektrike, ligjit të gazit natyror, ligjit të eficiencës së energjisë, ligjit të burimeve të rinovueshme të energjisë, modelit të tregut të energjisë elektrike dhe krijimin e bursës shqiptare të energjisë elektrike dhe shumë akteve të tjera të rëndësishme.

Ligji i ri për sektorin e energjisë elektrike u miratua në prill të vitit 2015 dhe është në përputhje me paketën e tretë të energjisë pasi transpozon direktivën 2009/72/KE dhe rregulloren (KE) 714/2009.

Në korrik 2016, Këshilli i Ministrave miratoi një model të ri tregu për rregullimin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri, si edhe planin për derregullimin e çmimeve duke mundur hapjen e tregut. Një plan veprimi për krijimin e Bursës së Energjisë, i cili parashikon një treg të organizuar të ditës në avancë (day-ahead) është, gjithashtu, pjesë e kësaj pakete.

Modeli i tregut parashikon integrimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike me atë të Kosovës dhe rajonit. Në shkurt 2018, me ndryshimet e ligjit të sektorit të energjisë elektrike,

është vendosur baza ligjore për krijimin e Bursës së Energjisë Elektrike në Shqipëri dhe krijimin e mundësive për krijimin e tregut të përbashkët me Kosovën, rajonin dhe me gjere. Në vijim të detyrimeve të përcaktuara, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është në përfundim të procesit të harmonizimit të legjislacionit dytësor që nevojitet për reformat dhe liberalizimin e tregut të energjisë elektrike. Strategjia Kombëtare e Energjisë – Shqipëria 2030 është rrjedhojë e reformave të guximshme dhe të vështira që ndërmori qeveria shqiptare në sektorin e energjisë elektrike, një reformë të thellë, produktet e së cilës tanimë janë të dukshme.

Rikthimi i ligjshmërisë në konsumin e energjisë elektrike solli rikthimin e besimit të humbur të partnerëve dhe donatorëve të cilët gjithnjë e më shumë po mbështesin projekte investimi.

Gjithashtu, investitorët privatë panë një treg energjetik gjithnjë e më likuid që u garanton kthimin e investimit dhe perspektivën e biznesit.

Në transmetim arritëm të përfundojmë linjën e interkonjeksionit elektroenergjetik 400 kV të Shqipërisë me Kosovën, duke vendosur edhe themelet e bashkë-punimit dhe krijimit të një burse të përbashkët për sektorin elektroenergjetik. Përfundam edhe linjën 110 kV të Unazës së Jugut, ndërsa po fillojmë ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 400 kV mes Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Ky plan strategjik ka vizionin e tij, zhvillimin e burimeve kombëtare të energjisë, që çon në një sistem rajonal të integruar e të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, sigurimin, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimale.

Ky plan strategjik përmban një sërë masash reformuese, me qëllim krijimin e një tregu të organizuar sipas modelit të Bashkimit Evropian, i cili bazohet në çmime konkurruese dhe udhëhiqet nga parimet e të qenit transparent, jodiskriminues dhe i qëndrueshëm.

### **III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, si dhe të neneve 11 dhe 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” si dhe është në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Marrëveshja do të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

### **IV. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION**

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision nga relatori u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme nëpërmjet së cilës qeveria e Republikës së Francës i jep mundësi Republikës së Shqipërisë të marrë një kredi të butë, për të përmirësuar proceset e reformës sektoriale në sektorin energjetik në Shqipëri duke plotësuar angazhimin ndërkombëtar lidhur me këtë reformim, i cili do të përfshijë, ndër të tjera, konsolidimin e ndarjes së OSHEE-së – Furnizuesit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, funksionimin e Bursës së Energjisë (APEX) dhe hapjen graduale të tregut të shitjes me pakicë, së bashku me krijimin e një tregu konkurrues të

energjisë sipas Vendimit Nr. 480 të Këshillit të Ministrave, datë 31.7.2018 “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË ENERGJISË PËR PERIUDHËN 2018–2030”.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision, Deputeti Z. Sula ngriti disa pyetje për Ministren e Financave si vijon: 1) Sa është nr. Total i kontratave të ngjashme të huas? 2) Sa nga këto kontrata huaje janë nënshkruar pas vitit 2013? 3) Sa është vlera totale e detyrimeve? 4) Kur parashikohen të shlyhen detyrimet nga këto kontrata? 5) Sa është detyrimi monetar për çdo qytetar?.

Znj. Ibrahimaj, në cilësinë e Ministres së Financave, theksoi parimin e transparencës për publikun në lidhje me detyrimet e huas.

Gjatë diskutimit, Komisioni mbështeti qëndrimin e relatorit dhe e vlerësoi projektligjin shumë të rëndësishëm.

## **V. PËRFUNDIM**

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

**Në aspektin ligjor**, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

**Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

**Në përfundim**, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me shumicën e votave, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

**RELATOR**

**EDUARD NDRECA**

**KRYETARE**

**KLOTILDA BUSHKA**